



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:005887  
Datë: 22.08.2024  
Numri i dokumentit: 01408635

KA.nr.864/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli-Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit DPH “OXYGEN.I” me seli në Prizren, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektorati Sanitar i Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulim i vendimit Nr. AUV.Ref.04/2-2386 i datës 11.12.2020, me propozim për anulim të vendimit, konform nenit 253.5 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, jashtë seancës me datë 22.08.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **KONSIDEROHET** e tërhequr padia e paditësit DPH “OXYGEN.I” me seli në Prizren, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektorati Sanitar i Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulim i vendimit Nr. AUV.Ref.04/2-2386 i datës 11.12.2020.
- II. Paditësi i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Në Gjykatën Komerciale-Departamenti për Çështje Administrative, Dhomat e Shkallës së Parë, Paditësi DPH “OXYGEN.I” me seli në Prizren, ka parashtruar padi me datë 14.01.2021, kundër të paditurës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektorati Sanitar i Republikës së Kosovës

me seli në Prishtinë, me objekt kontesti anulim i vendimit Nr. AUV.Ref.04/2-2386 i datës 11.12.2020.

Pas shqyrtimit paraparak të padisë u konstatua se nuk ka dëshmi që paditësi e ka paguar taksën gjyqësore për padi.

Gjykata me datë 18.06.2024 Paditësit i ka dërguar vërejtjen për pagesë të taksës, më të cilën e ka ftuar që brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e kësaj vërejtje, t'a paguaj taksën gjyqësore për padi, në shumën prej 50 euro, duke e paralajmëruar paditësin se nëse nuk e paguan taksën gjyqësore për padi, brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se padia është tërhequr konform nenin 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ lidhur me nenin 253 par.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Paditësi vërejtjen e taksës gjyqësore e ka pranuar me datë 24.06.2024 ndërsa edhe pas kalimit të afatit konstatohet se paditësi nuk ka vepruar sipas vërejtjes për taksë.

*Sipas nenit 253 paragrafi 4, Paditësi ka për detyrë që padisë t'ia bashkëngjisë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar, dhe sipas paragrafit 4, në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padi as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Andaj, gjykata konsideron se paditësi është tërhequr nga padia me propozim për anulim të vendimit dhe ka vendosur si në pikën I të këtij aktvendimi, duke e përfunduar procedurën në këtë çështje administrative. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.864/22, me datë 22.08.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLA JURIDIKE :** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.